



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.546/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Adnan Konushevcu kryesues, Rustem Thaqi dhe Faton Ademi anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Blerta Peci, duke vendosur lidhur me apelin e parashtruar nga Urim Hiseni, me vendbanim në Gjermani kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me seli në Prishtinë, për mos përfshirjen në listën përfundimtare të votuesve jashtë Kosovës, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që janë mbajtur më datë 14 Shkurt 2021, në seancën e panelit të mbajtur, më datë 03.03.2021, mori këtë:

V E N D I M

Hudhet i palejuar apeli A.nr.546/2021, i datës 02.03.2021, i parashtruar nga Urim Hiseni, me vendbanim në Gjermani, për mos konfirmim nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), me seli në Prishtinë, për përfshirjen në listën përfundimtare të votuesve jashtë Kosovës, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që janë mbajtur më datë 14 Shkurt 2021.

A r s y e t i m

Me datë 02.03.2021, PZAP-i ka pranuar një apel të parashtruar nga Urim Hiseni me vendbanim në Gjermani, të dorëzuar nëpërmjet postës me datën 03 shkurt 2021, me të cilin thekson se të dhënat e tij janë përzier nga KQZ-ja, ditëlindja dhe adresa e emailit janë shënuar gabimisht, emri i tij nuk është gjendur në listën e votuesve jashtë Kosove, dhe se i njëjti nuk ka pranuar asnjë thirrje nga ana e KQZ-së. Kërkon nga PZAP që të pranohet ankesa si e bazuar.

Paneli pasi që shqyrtoj lejueshmërinë e apelit gjeti se:

Ankesa është e palejuar

Paneli pas shqyrtimit të shkresave të lëndës gjeti se ankesa e parashtruar nga Urim Hiseni e dorëzuar nëpërmjet postës me datën 03 shkurt 2021, ka njëjtësi subjektive, objektive, gjendje të njëjtë faktike me apelin e parashtruar nga Urim Hiseni të paraqitur me datën 03.02.2021 kundër KQZ-së e cila çështje është vendosur me vendimin e PZAP-it Anr. 133/2021 të datës 05.02.2021.

Nga kjo gjendje e vërtetuar faktike rezulton se apeli i parashtruar nga Urim Hiseni është çështje e gjykuar “res iudicata”.

Meqenëse për rastin në fjalë është vendosur me vendimin e PZAP-it, Anr. 133/2021 të datës 05.02.2021, dhe pasi që për të njëjtën çështje është vendosur në vendimin e lartcekur paneli nuk u lëshua fare në shqyrtim të kësaj çështje të theksuar në ankesë.

Paneli, duke u bazuar në arsyet e cekuar më lartë e po ashtu në pajtim me dispozitat e nenit 6.4 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it 02/2015, si dhe në kuptim të nenit 115 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr. 546/2021 më datën 03.03.2021

Kryesues i Panelit
Adnan Konushëvci



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.